



Pranuar / Dorezuar Punë / Prerada Received / Delivery	12.04.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Agency Org / Unit	Rr. Pror. In Pror. Pror. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK 1726/2021			113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.122/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Avdyl Bektoshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.122/2021 të datës 05.03.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr.“Zenel Salihu”, Nr.22 në Prishtinë, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, respektivisht kundër organit të punësimit-Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.122/2021 e datës 05.03.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anullohet Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 01.02.2021 për ankuesen.
- III. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1004/2021 të regjistruar me numër A.nr.122/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 10.03.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Këshilli, me datë 22.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1004/2021 të regjistruar me numër A.nr.122/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.02.2021; E-mailin e datës 08.02.2021 nga ankuesja; E-mailin e datës 05.03.2021 nga ankuesja për ankesa.kpmsnck@rks-gov.net; Planin individual të punës nga ankuesja; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 31.01.2020, 21.12.2018; Akt Emërimit e ankueses të datës 01.08.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për Drejtor të Departamentit për Siguri dhe Cilësi; Vendimin me Nr.05/07 të datës 22.06.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 01/30 të datës 12.05.2020 të Kryeministrit në detyrë të Republikës së Kosovës dhe Përgjigjen në ankesë e datës 22.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit e datës 01.08.2018 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës të Drejtorit të Departamentit për Siguri dhe Cilësi në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, me datë 01.02.2021 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesen, duke e vlerësuar të njëjtën më notë të përgjithshme shumë mirë (3.6).

Ankuesja, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020, me datë 05.03.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 është bërë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, sepse sipas të njëjtës mbikëqyrësi i saj i drejtpërdrejtë, me datë 22.06.2020 është emëruar në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa i njëjti ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për periudhën janar-dhjetor 2020, duke përfshi edhe periudhën për të cilën nuk ka qenë Drejtor i Përgjithshëm, gjegjësisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar legjislacionin në fuqi, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se çështja e vlerësimit të rezultateve të punës të nëpunësve civil është e rregulluar me dispozitat e nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, dhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave mbi këtë bazë ligjore ka administruar provat e lëndës dhe ka konstatuar se me datë 22.06.2020, përmes Vendimit me Nr.05/07 të datës 22.06.2020 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa me datë 01.02.2021 i njëjti ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 për ankuesen, duke vlerësuar të njëjtën për periudhën kohore 01 janar - 31 dhjetor 2020, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për



Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 43 paragrafit 5 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, si dhe në kundërshtim me nenin 5 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punës të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Pra, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën 01 janar - 31 dhjetor 2020, ndërsa i njëjti ka qenë i obliguar të bëjë vlerësimin vetëm për periudhën përkatëse, respektivisht nga data 22.06.2020 - 31.12.2020, kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.*

Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2020 për ankuesen dhe kthimin e lëndës në rivlerësim të udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me rastin e rivlerësimit obligohet që të marr parasysh të gjeturat si me lartë dhe të veproje sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.122/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

